



Prishtinë: 13.06.2018

Kodi i ZRRE-së: V_997_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët;
- Rekomandimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_1804_05_18**;

në seancën e mbajtur më datë 13.06.2018, nxori këtë:

V E N D I M

I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit K. B., M. D, Komuna e Pejës, si në arsyet e paraqitura në këtë rekomandim.

A r s y e t i m

Pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë 03.12.2015 konsumatori K. B, M. D ka parashtruar ankesë me të cilën ka kundërshtuar përgjigjen e Departamentit për Konsumator në KESCO lidhur me mos aktivizimin e shifrës DPE-9023965 dhe ndërrimin e njehsorit elektrik, për shkak të mos kyçjes në trafo stacionin e me hershëm. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se më herët ka qenë i kyçur në atë trafo dhe se trafoja nuk është e pronarit të ish Metohijeremont, por e KEDS-it dhe se për këtë kërkon aktivizimin e shifrës DPE – 9023965.

Bordi i ZRRE-së, me qëllimit të vërtetimit të plotë gjendjes faktike e cila është iniciuar nga palët në kontest lidhur me pikën matëse të theksuar më lartë ka shqyrtuar dhe analizuar në detaje të gjitha dëshmitë e mbledhura për veprimet e ndërmarra nga palët në kontest lidhur me këtë pikë matëse.

Me datë 10.07.2017 konsumatori K. B, (M. D) me shifër DPE-9023965 ka bërë kërkesë zyrtare në KESCO për aktivizimin dhe ndërrimin e njehsorit elektrik.

Provë:Kërkesa e konsumatorit ne KESCO e datës 10.07.2017

Me datë 07.09.2017 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar se njehsorët e vjetër elektrik nr.6079122 (energjisë aktive) dhe njehsori nr.6122972 (energjisë reaktive) nuk ekzistojnë. Ekipi i KEDS-it në procesverbalin e përpiluar nga ana e tyre kanë evidentuar që konsumatori duhet të aplikoj në KEDS për lidhje të re përkatësisht pëlqim elektroenergjetik.

Provë: Raporti mbi kontrollimin-pranimin e grupit matës nr. 0054751 datë 07.09.2017

Me datë 07.12.2017 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar kërkesën e tij duke theksuar pamundësinë e kyçjes përkatësisht aktivizimit dhe ndërrimit te njehsorit elektrik ne piken e mëherëshme të kyçjes për shkak se aseti (trafo stacioni) nuk është pronë e KEDS-it dhe se ky trafo stacion tani gjendet në pronën e objektit te privatizuar “Dukagjini Remont”



dhe se nuk është në kontrollin e KEDS-it. Po ashtu ne përgjigjen e lëshuar nga KESCO është theksuar se trafo stacioni ne te cilin konsumatori ka qenë i kyçur me herët nuk figuron si aset i transferuar nga KEK me rastin e privatizimit.

Provë: Përgjigja e KESCO-s e datës 07.12.2017

I pakënaqur me përgjigjen e KESCO-s konsumatori me datë 08.12.2018 ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar që t'i bëhet aktivizimi si dhe ndërrimi në trafon ekzistuese ku ka qenë i kyçur edhe me herët, pasi sipas konsumatorit trafoja është aset i KEDS-it.

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

Me datë 10.07.2017 konsumatori K. B, (M. D) me shifër DPE-9023965 ka bërë kërkesë zyrtare në KESCO për aktivizimin dhe ndërrimin e njehsorit elektrik. Bazuar në kërkesën e konsumatorit, me datë 07.09.2017 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse (Grup matësve) kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar se njehsorët e vjetër elektrik nr.6079122 (energjisë aktive) dhe njehsori nr. 6122972 (energjisë reaktive) nuk ekzistojnë. Ekipi i KEDS-it ne procesverbalin e përpiluar nga ana e tyre kanë evidentuar qe konsumatori duhet te aplikoj ne KEDS per lidhje te re perkatësisht pëlqim elektroenergjetik.

Provë: Kërkesa e konsumatorit në KESCO e datës 10.07.2017 dhe Raporti mbi kontrollimin-pranimin e grupit matës nr. 0054751 i datës 07.09.2017

Me datë 07.12.2017 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar kërkesën e tij. Në përgjigjen e lëshuar është përshkruar po ashtu i tërë historiku i shpenzimeve të regjistruara në shifrën DPR-9023965, si dhe arsyeja e shkyçjes nga rrjeti elektrik të objektit. Sipas përgjigjes së lëshuar kjo shifër ka qenë e regjistruar në bazën e të dhënave të KEK/KESCO-s që nga paslufta dhe se ka pasur shpenzim aktiv deri në periudhën 07/2004 dhe se prej kësaj periudhe e deri në periudhën 08/2013 nuk ka pasur faturim të kWh, përveç tarifave fikse. Si rrjedhojë e këtij faturimi pasiv, si dhe duke marrë parasysh qe ky objekt ka qenë i shkyçur, i demoluar dhe pa ndonjë pagese për një kohe të gjatë (nga viti 2004) është bërë mbyllja e kësaj llogarie në databazën tonë. Po ashtu është theksuar se me rastin e pranimit të kërkesës së konsumatorit për aktivizim të shifrës dhe ndërrim të njehsorit, me datën 07.09.2017 ekipet e autorizuar të KEDS kane dal në vend të ngjarjes për të bërë inspektimet e nevojshme në mënyrë që të procedohet me tutje me kërkesën . Me këtë rast ekipi kontrollues ka konstatuar që kjo shifër e pasivizuar, rrjeti i së cilës është i shkyçur dhe njehsori i së cilës nuk ekziston duhet të aplikoj për kushte të reja të kyçjes respektivisht për Pëlqim Elektroenergjetik. Rekomandimi i ekipit të kontrollues bazohet në faktin se kushtet aktuale për kyçje nuk mundësojnë kyçjen ku ka ekzistuar kyçja me parë duke marrë parasysh transferet e pronave që kanë ndodhur ndërkohë, si dhe demolimet e rrjetit që nga viti 2004 e deri me sot. Për me tepër, trafostacioni në fjalë (i cili ka furnizuar edhe objektin tuaj me parë) është privatizuar në vitin 2011. Për informimin tuaj, ky trafostacion ka qenë dhe vazhdon të jetë i vendosur në parcelën e cila është pronë e privatizuar nga Autoservis Dukagjini remont shpk. Pronari i ri i kësaj parcele(objekti) me datën 09.10.2012 ka parashtruar një kërkesë në KEK (Divizionin i rrjetit) për të vërtetuar nëse ky trafostacion është aset i KEK respektivisht i regjistruar në librat amë të saja. Me 10.10.2012 KEK ka lëshuar një vërtetim ku deklarohet se asetit në fjalë (trafostacioni) nuk është i regjistruar si aset në librin e mjeteve themelore të KEK-ut. Duke pasur parasysh krejt këto që u tha më lartë, KEDS nuk ka të drejte të kyç ndonjë konsumatorë në asetet mbi të cilat nuk ka kontroll, nuk i ka në pronësi të vet, respektivisht nuk ka dëshmi që janë transferuar nga KEK-u me rastin e privatizimit. Për informimin tuaj, kyçja në asete të palëve të treta mund të lejohet nga KEDS vetëm me kushtin që aplikuesi /parashtruesi kërkesës të ofrojë paraprakisht dëshmi nga ana e pronarit të asetit privat mbi lejimin e shfrytëzimit të përbashkët te asetit përkatës. Po ashtu në përgjigje konsumatori është njoftuar që KEDS nuk refuzon kyçjen e asnjë konsumatori përderisa ekzistojnë kushtet e kyçjes. Për me tepër, në rastin konkret KEDS është i gatshëm që pas aplikimit nga ana juaj për Pëlqim Elektroenergjetik, t'ju ofrojë zgjidhjen teknike optimale për kyçje me kushtin që ju me mjetet e juaja vetanake të investoni deri në pikën me të afërt të përcaktuar sipas Pëlqimit Elektroenergjetik.



Provë: Përgjigja e KESCO-s e datës 07.12.2017

Bordi i ZRRE ka analizuar përgjigjën e lëshuar nga KESCO si dhe dokumentacionin e përmendur në përgjigjën e lëshuar dhe konstaton se konsumatori me shifër DPE-9023965 deri në periudhën korrik 2004 ka qenë aktiv përkatësisht është faturuar me shpenzime reale mujore kurse nga kjo periudhë deri në periudhën gusht 2013 është faturuar vetëm me taksa pa shpenzim. Në bazë të dokumentacionit të ofruar nga dy palët vërtetohet se kompania NSH Metohija Remont me datë 09.10.2012 ka bërë kërkesë zyrtare në KEK me qëllim që të verifikohet pronësia mbi trafostacionit 400 kVA blindë metalike, e cila gjendet në pronën e fabrikës së privatizuar nga AKP dhe se në të janë të kyçura po ashtu një pompe e benzinës, si dhe ish Motel Dardania. Në kërkesë është cekur po ashtu që ky trafostacion figuron në mjetet themelore të ndërmarrjes Metohijaremont. Bazuar në kërkesën e kompanisë Metohijaremont (pronari i ri Auto Servis Dugagjiniremont SH.P.K), KEK me datë 10.10.2012 ka lëshuar vërtetimin në të cilin thuhet se TS Metohijaremont nuk është në regjistruar si aset në librin e mjeteve themelore në DPE. Me datë 12.09.2013 kompania Auto Servis Dugagjiniremont SH.P.K me pronarë Atdhe Kelmendin ka bërë kërkesë zyrtare në KEDS për dislokimin e trafos për shkak të ndërtimit të objektit duke marr përsipër të gjitha obligimet e parapara për dislokim. Me datë 10.10.2013 KEDS-Divizioni i Shpërndarjes Prishtine i ka lëshuar zgjidhjen teknike për dislokimin e trafos duke përshkruar edhe të gjitha kërkesat teknike të cilat duhet plotësuar aplikuesi për kyçjen e serishme të trafos në rrjetin elektrik.

Provë: Kërkesa e Auto Servis Dugagjiniremont SH.P.K datë 09.10.2012 dhe vërtetimi KEK Sha. Prishtinë, Distrikti Pejë i datës 10.10.2012, kërkesa e konsumatorit për dislokim nr. 670 e datës 12.09.2013 si dhe zgjidhja teknike KEDS nr.6468 e datës 10.10.2013

Me datë 17.11.2017, ZRRE i është drejtuar Agjencionit Kosovar për Privatizim me shkresë zyrtare me të cilën ka kërkuar sqarime shtesë lidhur me pronësinë e trafos si dhe asetëve të cilat kanë kaluar në pronësi të blerësit të ish Metohijaremont. Me datë 23.11.2017, ZRRE ka pranuar përgjigjën nga AKP lidhur me sqarimet e kërkuara e në të cilën thuhet se: Lidhur me kërkesën tuaj ju informojmë që Ndërmarrja e re Dukagjiniremont (ish NSH Metohijaremont) ka qenë e përfshirë në valën e 49-të të privatizimit. Në kohën kur kjo Ndërmarrje e re është e përgatitur për shitje. e njëjta ka qenë duke u shfrytëzuar nga EULEX dhe ne nuk kemi pasur qasje në objekte. Të dhënat lidhur me objektet që iu janë bart ndërmarrjes se re respektivisht blerësit janë bazuar në një listë të objekteve të cilin na ka dorëzuar ndërmarrja e datës 22 dhjetor 1992, si dhe lista e cila është përgatitur nga "Agjencia e Inxhinjeringut "Ekonomik Biro" nga Beogradi", Shtator 1992". Sipas dokumenteve që i kemi pasur në dispozicion e që janë shpalosur në dokumentet e shitjes është cekur që Subjektit të Ri do t'i transferohen objektet e përshkruara si në vijim:

1. Holli kryesor për riparimin e makinave të udhëtareve, ndërtuar me 1972., materiali çimento dhe armature me strukture çeliku, si dhe kati prej xhami me lartësi 5,50 m. Në brendi të hollit ka një hapësirë dedikuar për zyrë menaxhuese dhe administrative. Holli kryesor është i pajisur me të gjitha instalimet.
2. Objekti për shërbime të shpejta dhe kontroll teknike ndërtuar me 1979 dhe ka strukturë çimentoje me armaturë me lartësi nga 4.50 m deri 6.00 m.
3. Objekti për riparimin e mjeteve të mëdha, ndërtuar me 1979, strukture çeliku, lartësi 5.5m.
4. Dhoma e zdrukthëtarisë me kazan për ngrohje dhe pjesën me motor si dhe dhomën ndihmese ndërtuar me 1979, struktura çimento me armature, lartësia 3.5m.
5. Kabina e punëtorit të sigurimit fizik ndërtuar në vitin 1972 prej materiali çimento dhe çelik.



Shënim: Sipërfaqja e përgjithshme e objekteve e prezantuar në raportin mbi vlerësim ku janë marr informatat e vendosura me lartë, si dhe sipërfaqja e përgjithshme e objekteve që është e prezantuar në fletë posedim dallon. Gjithashtu, që nga 1999, fillimisht UNMIK-u dhe pastaj EULEX-i kanë bërë një investim brenda dhe jashtë objekteve të përfshira në Subjektin e Ri. Por, Zyra Rajonale e AKP-se në Pejë (ZR) nuk posedon informata të sakta mbi investimet e bëra si dhe gjendjen momentale të objekteve dhe nuk i ka aprovuar ato. Gjithashtu në kopjen e planit të datës 16.03.2011 trafostacioni nuk figuron si objekt i regjistruar në paluajtshemrine e cila i është bartur NR Dukagjiniemont. Nga raporti i përgatitur nga Agjencia e Inxhinjeringut “Ekonomik Biro” nga Beogradi i Shtatorit të vitit 1992 ceket që në kuadër të kompleksit ekzistojnë edhe trafostacioni i tipit të objektit të përkohshëm, cisterna me shtëpizë (me mazut) si dhe objekti i kabinës së vjetër të sigurimit i cili nuk është në funksion, andaj nuk është trajtuar në këtë vlerësim, ku i vetmi dokument ku ceket trafoja është ky raport dhe ne meqë nuk kemi pasur qasje në objektet për arsyet e lartcekura nuk kemi mundur të vendosim këtë informate pa e vërtetuar sakte këtë rrethane , por jemi bazuar vetëm ne liste te asetëve të vitit 1992. Po ashtu, ZRRE me datë 05.12.2017 ka kërkuar nga KEDS që të verifikohet se a është i regjistruar dhe a ka qenë më herët aset i KEK-ut TS Metohijaremont (Distrikti i Pejës), ose me numrin CEJA 5414. Me datë 05.12.2017 ka marr përgjigje nga KEDS që ky aset nuk është regjistruar si aset i KEDS-it as me emrin dhe as me kodin e kërkuar.

Provë: Përgjigja nga AKP e datës 23.11.2017, kërkesa e ZRRE-së drejtuar KEDS datë 05.12.2017 dhe përgjigja e pranuar nga KEDS

Bordi i ZRRE-së bazuar në dokumentacionin e ofruar nga palët e në veçanti dokumentacionin e pranuar nga AKP dhe KEK me të cilin vërtetohet blerja e ish objektit të NSH Metohija Remont në pronën e të cilit ka qenë edhe trafo, **si dhe pronësia e trafos** në të cilën me herët ka qenë i kyçur Motel Dardania, konstaton se KEDS ka vepruar në përputhje me nenin 45 parag. 1 të Ligjit për Energjinë Elektrike, ku thuhet se: Operatori i Sistemit të Transmetimit apo Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të refuzojnë qasjen në sistemin e transmetimit apo të shpërndarjes nëse nuk ka në dispozicion kapacitete të nevojshme, dhe nëse mungesa e kapaciteteve arsyetohet në mënyrë objektive në bazë të kriterëve të arsyeshme teknike, duke pasur parasysh sigurinë e furnizimit, ose cilësisë së furnizimit, duke marrë parasysh standardet e shërbimit dhe besueshmërinë e kërkuar nga personi që kërkon qasje, si dhe të gjitha kodet dhe rregullat në fuqi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 13.06.2018 ka konstatuar se duke pasur parasysh të gjitha faktet e përmendura më lartë, pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët e në veçanti dokumentacionin e pranuar nga AKP dhe KEK me të cilin vërtetohet blerja e ish objektit të NSH Metohija Remont në pronën e të cilit ka qenë edhe trafo, si dhe pronësia e trafos në të cilën me herët ka qenë i kyçur Motel Dardania,, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 13.06.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.



Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit: Daut Gashi,
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.